

VENDIM
Nr. 555, datë 31.7.2019

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 286, DATË 21.5.2018,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR DISA RREGULLA TË VEÇANTA PËR
PUNËMARRËSIT E PËRKOHSHËM, TË CILËT PUNËSOHEN NGA AGJENCITË
E PUNËSIMIT TË PËRKOHSHËM”¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 286, datë 21.5.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Pas pikës 2 shtohet pika 2.1, me këtë përmbajtje:

“2.1 Agjencia e përkohshme e punësimit informon punëmarrësin me marrëdhënie punësimi të përkohshme përpara fillimit të marrëdhënieve të punës për rreziqet specifike në vendin e punës, si dhe mbi çdo kualifikim ose aftësi të posaçme profesionale ose mbikëqyrje të veçantë mjekësore, që kërkon vendi i punës.”.

2. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Ndërmarrja pritëse u siguron punëmarrësve të përkohshëm trajnimin e nevojshëm dhe në përputhje me karakteristikat e vendit të punës, njësoj si punëmarrësve të përhershëm, duke marrë parasysh kualifikimin dhe eksperiencën e tyre, me qëllim përmirësimin e aftësive dhe të njohurive të tyre për fushën e pozicionit ku janë punësuar.”.

3. Pas pikës 5 shtohet pika 5.1, me këtë përmbajtje:

“5.1 Punëmarrësit e punësuar nëpërmjet agjencive të përkohshme që bëjnë pjesë në grupet e rrezikuara, sipas legjislacionit në fuqi, mbrohen ndaj rreziqeve që i prekin ata në mënyrë të veçantë. Punëdhënësi siguron për këtë kategori punëmarrësish mbikëqyrje të veçantë mjekësore, sipas legjislacionit në fuqi.”.

II. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore si dhe agjencitë e punësimit të përkohshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

¹ Direktiva e Këshillit e datës 25 qershor 1991, që plotëson masat për nxitjen e përmirësimeve në sigurinë dhe shëndetin në punë të punëtorëve me marrëdhënie pune të qëndrueshme ose marrëdhënie të përkohshme të punës (91/383 / EEC) (OJ L 206, 29.7.1991, f. 19).